



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRANAK LIPLJAN

P.nr.749/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, në lëndën penale, ndaj të pandehurit N. J. nga F., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.6664/14 të dt.31.10.2016, për shkak të veprës penale, Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.07.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Fatmire Cacaj, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij A. T. av. në L., me datë 09.02.2017 merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

N. J., nga i ati F., dhe e ëma S., e gjinisë R., me nr. personal *numri personal...*, i lindur me dt. *data e lindjes...*, me vendbanim në F., i martuar, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 15.09.2014, rreth orës 15:00, në Lipjan në rr. “Lidhja e Prizrenit”, derisa njësi policor i biçiklistave gjatë detyrës zyrtare, ka ndalur të pandehurin, i cili ishte duke drejtuar automjetin e tij “Ford” me targa *numri i targave...* dhe për ti shkruar një tiketë për shkak se nuk ka pas rripin e sigurisë, nuk është pajtuar me të dhe pas një fjalosje ka kanosur policin-tani të dëmtuarin A. A., me fjalët “me ty lehtë e ka, kur ta heqësh uniformën në ora 18:00 takohemi”, si dhe duke fyer policin M. J., me fjalët “ku të nxa kam me ta q.. p.. të nanës” me ç’rast te të njëjtit ka shkaktuar ndjenjën e ankthit dhe frikësimit.

-me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 185 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurin e gjykon me :

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit A. A. dhe M. J. zyrtar policor, udhëzohen që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor t’ia paguaj shumën prej 100 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.6664/14 të dt.31.10.2016, e ka akuzuar të pandehurin N. J., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në konsultim me mbrojtësin e tij, i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe në të njëjtën kohë nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase me të dëmtuarin janë shokë, por kjo kishte ndodhur vetëm për shkak të një keqkuptimi, dhe gjithashtu kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Mbrojtësi i të pandehurit gjithashtu e ka mbështetur pranimin e fajësisë nga ana e klientit të tij, dhe kësaj gjykate i ka propozuar që me rastin e matjes së dënimit, të mbrojturit të tij ti shqiptohet një dënim sa më i butë, duke pasur parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Kanosje nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, shprehjen e keqardhjes, pendimin, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 749/16 dt.09.02.2017

**Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.